



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 61, datë 22.05.2020

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET AUTORITETIT
TË MBIKËQYRJES FINANCIARE DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 18, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ervin METE _____ **KRYETAR**

Idlir GJATA _____ **ANËTAR**

Deniz DERALLA _____ **ANËTAR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES
FINANCIARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E
PËRGJITHSHME E
PARANDALIMIT TË
PASTRIMIT TË PARAVE

Nr. ____ Prot, datë _____

Nr. ____ Prot, datë _____

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

DHE

AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TË ICRG/FATF

Duke qenë se Shqipëria është listuar në grupin e vendeve në monitorim të shtuar nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF)¹, ndryshe “listim në listën Gri”²;

Duke qenë se ICRG³/ FATF ka hartuar një “Plani veprimi”⁴ të detajuar me rezultate imediate (IO⁵) dhe afate konkrete për tu përmbushur nga Shteti Shqiptar⁶, deri në qershor 2021;

Duke qenë se Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave ka ngritur “Grupin Ndërinstitucional të Punës për përmbushjen e detyrave dhe të rekomandimeve të lëna nga ICRG/ FATF” me Vendimin nr. 1, datë 19.02.2020 *“Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar”*

¹ Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (Financial Action Task Force/ FATF).

²<http://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/documents/increased-monitoring-february-2020.html#albania>.

³ICRG (International Cooperation Review Group) / Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, pjesë e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (Financial Action Task Force / FATF).

⁴“Plani i veprimit”/ “Action plan” i hartuar nga ICRG/ FATF (në versionin zyrtar anglisht) gjendet në dokumentin bashkëlidhur kësaj marrëveshje “Vendimi nr. 1, datë 19.02.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar”.

⁵ “Immediate outcome”.

⁶ Aneks. 1 “Plani veprimit të ICRG/FATF me nën hapa” (në versionin shqip), ku janë pasqyruar të gjitha detyrat që duhet të përmbushin të gjitha institucionet përgjegjëse në afatet e përcaktuara.

(*bashkëlidhur*), në mbështetje të nenit 23, të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 4, të Rregullores “Për funksionimin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave”;

Duke qenë se Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është pjesë e “Grupit Ndërinstitucional të Punës për përmbushjen e detyrave dhe të rekomandimeve të lëna nga ICRG/FATF”, duke u përfaqësuar nga drejtues i nivelit të lartë⁷;

Duke qenë se përmbushja e plotë e rekomandimeve të FATF dhe “Planit të veprimit” të ICRG/FATF në afatet e përcaktuara për secilin institucion përgjegjës, është në interesin madhor të Shqipërisë, sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

Lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis palëve të mëposhtme:

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) në cilësinë e Sekretariatit Teknik⁸ të “Grupit Ndërinstitucional të Punës për përmbushjen e detyrave dhe të rekomandimeve të lëna nga ICRG/FATF”, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Elvis Koçi, këtu e më poshtë referuar në këtë marrëveshje si “DPPPP”;

dhe

Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në cilësinë e institucionit të ngarkuar nga “Plani i veprimit të ICRG/FATF” për të përmbushur detyrat dhe rekomandimet e lëna nga ICRG/FATF” përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Mete, këtu e më poshtë referuar në këtë marrëveshje si “AMF”.

QËLLIMI I MARRËVESHJES

- Marrëveshja ka si qëllim *përcaktimin e detyrave* (rezultateve imediate – IO) që duhet të përmbushë secila palë brenda afateve të përcaktuara në “Planin e veprimit” të ICRG/FATF.
- Marrëveshja ka si qëllim *angazhimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë* midis palëve me të gjitha kapacitetet institucionale, në funksion të përmbushjes së plotë të detyrave (rezultateve imediate – IO) brenda afateve të përcaktuara në “Planin e veprimit” të ICRG/FATF.
- Marrëveshja ka si qëllim *ndjekjen, raportimin dhe përmbushjen e plotë* të rekomandimeve të FATF dhe të detyrave (rezultateve imediate – IO) në “Planin e veprimit” të ICRG/FATF, në respektim dhe përmbushje të plotë të afateve të përcaktuara.

⁷ Pika 2 (g) e “Vendimit nr. 1, datë 19.02.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar”.

⁸ Pika 10 e “Vendimit nr. 1, datë 19.02.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar”.

DETYRAT E PALËVE

Në kuadër të përmbushjes të rekomandimeve dhe detyrave (rezultateve imediate – IO) të “Planit të veprimit” të ICRG/ FATF, evidentuar në dokumentin që i bashkëlidhet kësaj marrëveshje bashkëpunimi⁹:

I. DPPPP duhet të përmbushë brenda afateve të përcaktuara detyrat si më poshtë:

1. Të mbledhë dhe administrojë raportimet javore të përcjella nga AMF, si dhe çdo të dhënë/dokument tjetër në funksion të tyre;
2. Të raportojë, mbi baza javore, çdo ditë të martë, pranë Kryetarit të Grupit Ndërinstitucional të Punës, të dhënat dhe rezultatet e raportuara nga AMF mbi bazën e ecurisë të planit të veprimit;
3. Të marrë masa, nëse do të kërkohet, për të koordinuar procesin e punës të AMF-së me institucionet e tjera;
4. Të ofrojë çdo asistencë tjetër të nevojshme, të kërkuar nga Kryetari i Grupit Ndërinstitucional të punës dhe AMF-së, në kuadër të përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

II. AMF duhet të përmbushë brenda afateve të përcaktuara detyrat si më poshtë:

1. *Të raportojë pranë DPPPP të dhëna të mbledhura në lidhje me “rrezikun e pastrimit të parave” për subjektet që ka në mbikëqyrje/ subjekte të sistemit financiar jobankar dhe operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor, të dhëna të mbledhura në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që vepron AMF. Referenca në “Planin e veprimit” IO.1¹⁰/ raportim mbi baza javore/ Afati fundor - korrik 2020 ;*
2. *Të hartojë një plan të hollësishëm lidhur me nevojat për trajnim me fokus të veçantë pasqyrimin e rekomandimeve dhe detyrave të ICRG/FATF dhe Moneyval rreziqet nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Referenca në “Planin e veprimit” IO.10.1¹¹/ raportim mbi baza javore/ Afati fundor - maj 2020;*
3. *Në bashkëpunim me DPPPP të organizojë trajnime në lidhje me rritjen e vigjilencës së duhur/ pastrimin e parave/ financimin e terrorizmit dhe rekomandimet e FATF. Referenca në “Planin e veprimit” IO.10.1¹²/ raportim mbi baza javore/ Afati fundor-korrik 2020;*

⁹ Aneks. 2 “Plani e veprimit të ICRG/FATF me nen hapa/ Institucioni përgjegjës AMF” ku janë evidentuar specifikisht detyrat që duhet të përmbushë AMF në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë plan, bashkëlidhur.

¹⁰IO. 1 “Shqipëria duhet të kryejë analiza të mëtejshme lidhur me sektorë specifikë dhe produkte specifike që paraqesin risk për kryerjen e pastrimit të parave, duke u përqendruar kryesisht në pasuritë e paluajtshme, agjentët e pasurive të paluajtshme, ekspertët kontabël dhe abuzimin me format e ndryshme të personave juridikë”.

¹¹ 1. Shqipëria duhet të rrisë ndjeshëm angazhimin me “Institucionet financiare” (FI) dhe me “Bizneset dhe Profesionet e caktuara jofinanciare” (DNFBPs) (veçanërisht me ato subjekte që Shqipëria ka identifikuar të ketë njohuri të pamjaftueshme dhe / ose përmbushjes të “Sanksioneve financiare të specifike”/ TFS) duke realizuar një komunikim dinamik, të rregullt (në plotësim të detyrimit për njoftimin e udhëzimeve të përditësuara mbi “Listën e personave të shpallur”).

¹² 1. Shqipëria duhet të rrisë ndjeshëm angazhimin me “Institucionet financiare” (FI) dhe me “Bizneset dhe Profesionet e caktuara jofinanciare” (DNFBPs) (veçanërisht me ato subjekte që Shqipëria ka identifikuar të ketë njohuri të pamjaftueshme dhe / ose përmbushjes të “Sanksioneve financiare të specifike”/ TFS) duke realizuar një

4. Të hartojë *plane inspektimi* bazuar në rreziqet e pastrimit të parave / financimit të terrorizmit dhe “Sanksionet specifike financiare të personave të shpallur” (TFS), si dhe përfshirjen e këtyre komponentëve në inspektimet që AMF do të realizojë. *Referenca në “Planin e veprimit” IO.10.2¹³/raportim mbi baza javore/ Afati fundor - maj 2020;*
5. Të propozojë, komunikojë me shkrim apo në formë elektronike me DPPPP, lidhur me çdo veprim konkret dhe të efektshëm për realizimin e detyrave të përmendura në këtë marrëveshje bashkëpunimi;
6. Të mundësojë dokumentimin e kryerjes së detyrave të caktuara më sipër dhe atyre të propozuara prej saj në rrugë elektronike;
7. Të marrë pjesë në çdo mbledhje që do të thirret nga Kryetari i Grupit Ndërinstitucional të punës (Zëvendës Kryeministri i Shqipërisë)¹⁴;
8. Të raportojë në mënyrë të hollësishme mbi baza javore, *çdo dite të premte*, për çdo pikë veprimi/ nën-hap të realizuar në përputhje me “Planin e veprimit të ICRG/FATF”, sipas formatit standard të raportimit që vihet në dispozicion nga DPPPP.

ANGAZHIMET E PËRBASHKËTA TË PALËVE

1. Palët informojnë në kohë njëra-tjetrën për ecurinë e zbatimit të pikave të planit të veprimit zhvillimet e fundit në raport me to, kërkesat që kanë karshi njëra-tjetrës apo të tjerave në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të tyre.
2. Palët hartojnë bashkërisht çdo dokument tjetër të nevojshëm për përmbushjen e detyrave.
3. Palët bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë opinione në rastin e hartimit ose ndryshimit të akteve ligjore apo nënligjore që lidhen me zbatimin e Planit të Veprimit.
4. Palët bashkëpunojnë dhe ofrojnë asistencë të specializuar sipas veprimtarisë së tyre dhe në varësi të kërkesave nga të dyja palët.

PROCEDURA PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT

1. Palët komunikojnë dhe lidhen me njëra-tjetrën për efekt bashkëpunimi, në rrugë zyrtare (me shkrim), në rrugë elektronike dhe çdo lloj forme tjetër të përshtatshme komunikimi e cila të zyrtarizohet më pas me shkrim për çështjet më të rëndësishme.
2. Palët në rrugë elektronike shkëmbejnë informacion nëpërmjet adresës elektronike moneyval@kryeministria.al (adresë elektronike (e-mail) ku AMF duhet të kryejë raportimin javor brenda çdo dite të premte).

komunikim dinamik, të rregullt (në plotësim të detyrimit për njoftimin e udhëzimeve të përditësuara mbi “Listën e personave të shpallur”).

¹³ IO.10.2 “2. Shqipëria duhet të sigurojë që procedurat përkatëse të inspektimit nga subjektet mbikëqyrëse (përfshirë, potencialisht, përmes rishikimit) dhe inspektimet aktuale të kryera për vlerësimin e pajtueshmërisë të “Sanksioneve financiare specifike” (TFS) për “personat e shpallur” janë dukshëm të mjaftueshme për të identifikuar dhe korrigjuar mangësitë në pajtueshmërinë e vendosjes të “sanksioneve financiare specifike për personat e shpallur” (TFS) midis institucioneve financiare (FI)-ve dhe “Bizneseve dhe Profesioneve të caktuara jofinanciare” (DNFBPs).”

¹⁴ “Zëvendës Kryeministri” Pika 3 e Vendimit nr. 1 datë 19.02.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar”.

PERSONAT E KONTAKTIT

Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit sipas kësaj marrëveshje, palët përcaktojnë personat e kontaktit, të cilët mbajnë dhe realizojnë çdo komunikimin nëpërmjet tyre, përveç rasteve kur do të dakordësohet eventualisht ndryshe.

Personat e kontaktit do të jenë si më poshtë:

- DPPP përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPP;
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Mete.

NDRYSHIMET DHE HYRJA NË FUQI E MARRËVESHJES

1. Marrëveshja e bashkëpunimit mund të ndryshohet midis palëve në funksion të kërkesave që do të paraqiten nga ICRG/ FATF, si dhe për saktësim, qartësim të detyrave, apo shtesa që mund të lindin si nevojë në funksion të zbatimit të planit brenda afateve të përcaktuara.
2. Marrëveshja e bashkëpunimit në asnjë rast nuk mund të ndryshojë *afatet fundore* të përcaktuara në “Plan veprimin e ICRG/FATF”. Në çdo rast çdo ndryshim i parashikimeve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të bëhet me shkrim.
3. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.
4. Kjo marrëveshje u hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

AUTORITETI I MBIKËQYRJES

FINANCIARE

Përfaqësuar nga,

Z. Ervin METE

Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv

DREJTORIA E PËRGJITHSHME

E PARANDALIMIT TË

PASTRIMIT TË PARAVE

Përfaqësuar nga,

Z. Elvis KOÇI

Drejtore i Përgjithshëm

Z. Erion BRAÇE

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

KRYETAR I GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË GRUPIT TË POSAÇËM TË VEPRIMIT FINANCIAR

Dokumentet bashkëlidhur kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi:

- Vendimi nr. 1, datë 19.02.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar”;
- Aneks. 1 “Plani i veprimit të ICRG/FATF (me nen hapa)” (në versionin shqip) – të gjitha institucionet;
- Aneks. 2 “Plani i veprimit të ICRG/FATF” (me nen hapa) - institucioni përgjegjës Ministria e Drejtësisë.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Përkthim “Jo - zyrtar” i DPPPP

ANEKS. 1

PLANI I VEPRIMIT TË ICRG/ FATF¹⁵

(me nën - hapa)

Rezultati imediat (Immediate Outcome) IO	PIKA E VEPRIMIT / NËN- HAPI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS/	AFATI
<p>IO.1</p>	<p>(IO1.1)</p> <p>1. Shqipëria duhet të kryejë analiza të mëtejshme për sektorë specifikë dhe produkte specifikë që paraqesin rrezik dhe ekspozim lidhur me “pastrimin e parave”¹⁶, me fokus të veçantë në sektorin e pasurive të paluajtshme, agjentët e pasurive të paluajtshme, avokatët, ekspertët kontabël dhe shpërdorimin me formë të ndryshme të veprimtarisë të personave juridikë.¹⁷</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i> Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të parave (DPPPP)</p> <p><i>Institucione Mbështetëse:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Drejtësisë (MD) - Prokuroria e Përgjithshme (PP) - Prokuroria e Posaçme (SPAK) - Dhoma Kombëtare e Avokatëve (DHKA) - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) - Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) - Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) 	<p>SHKURT 2021</p>

¹⁵Plan veprimi i ICRG (International Cooperation Review Group) / Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, pjesë e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (Financial Action Task Force / FATF)

¹⁶ Money laundering (ML)/ pastim parash (PP)

¹⁷IO.1. “Albania should conduct further analysis in relation to the sector-specific and product-specific ML threats and vulnerabilities, with particular emphasis on immovable property, real estate agents, lawyers, accountants and the misuse of different types of legal persons.”

		<ul style="list-style-type: none"> - Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKP) - Banka e Shqipërisë (BSH) - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) - Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) - Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) - Agjencisë Shtetërore e Kadastrës (ASHK) 	
	<p>(IO.1.2)</p> <p>2. Shqipëria duhet të forcojë më tej koordinimin dhe bashkëpunimin institucional për zbatimin e masave të nevojshme që rrjedhin nga Vlerësimi Kombëtar i Riskut (NRA) dhe analizat¹⁸ në pikën 1 më lart, mundësisht përmes një “Plani veprimi” të vetëm, të konsoliduar dhe gjithëpërfshirës.¹⁹</p>	<p><u>Institucion kryesues:</u> Grupi Ndër-Institucional (GNI) (ZvKM/ DPPPP)</p> <p><u>Institucione Mbështetëse:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Drejtësisë (MD) - Prokuroria e Përgjithshme (PP) - Prokuroria e Posaçme (SPAK) - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) - Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) - Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) - Banka e Shqipërisë (BSH) - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) 	SHKURT 2021

¹⁸ Analizave që do të realizohen në përmbushje të IO.1.1 për sektorë specifikë dhe produkte specifike që paraqesin rrezik dhe ekspozim lidhur me “pastrimin e parave”, me fokus të veçantë në sektorin e pasurive të paluajtshme, agjentët e pasurive të paluajtshme, avokatët, ekspertët kontabël dhe shpërdorimin me format e ndryshme të veprimtarisë të personave juridikë.

¹⁹(IO.1.2) 2. “Albania should further strengthen institutional coordination and cooperation for the implementation of the necessary measures derived from the NRA and the analysis in point 1 above, preferably through a single consolidated and comprehensive Action Plan.”

		- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)	
(IO.1.3)	3. Shqipëria duhet të: i) demonstrojë përparim të qenësishëm në zbatimin e Projektit të Fiskalizimit për trajtimin e ekonomisë informale dhe zvogëlimin e përdorimit të parave fizike, veçanërisht duke zbatuar sistemin për faturat Biznes-Konsumator për të gjitha subjektet (bizneset). ²⁰	<i>Institucion kryesues:</i> Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) <i>Institucion Mbështetës:</i> - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)	SHKURT 2021
	ii) demonstrojë regjistrim të plotë dhe të saktë të detajeve të pronësisë së pasurive të paluajtshme në zonat urbane dhe progres të qenësishëm në lidhje me regjistrimet e mbetura të zonave kadastrale rurale. ²¹	<i>Institucion kryesues:</i> - Agjencisë Shtetërore e Kadastrës (ASHK)/ <u>Institucion kryesues</u>	PRILL 2021

²⁰ 3. Albania should:

i) demonstrate significant progress on implementation of the Fiscalization Project for tackling the informal economy and reducing the use of cash, in particular by implementing the system for Business-to-Customer invoices for all businesses.

²¹ ii) demonstrate complete and accurate registration of ownership details of immovable property in urban zones and adequate progress in relation to the remaining rural cadastral zone registrations.

<p>IO.2</p>	<p>(IO.2) Shqipëria duhet vërë në përdorim një sistem elektronik të menaxhimit të çështjeve për prioritizimin sistematik të <i>letër-porositë</i> për të gjitha autoritetet e përfshira deri në pikën që sistemi të jetë funksional (duke përfshirë të gjitha letër-porositë që s'kanë marrë ende përgjigje, në momentin e bërjes operacional të sistemit).²²</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i> Ministria e Drejtësisë (MD) <i>Institucion Mbështetës:</i> - Prokuroria e përgjithshme (PP)</p>	<p>PRILL 2021</p>
--------------------	---	--	--------------------------

²²IO.2 “Albania should introduce an electronic case management system for the systemic prioritisation of MLA cases for all authorities involved to the point that the system is operational (including in relation to all outstanding MLA cases at the point of operationalization).”

<p>IO.3</p>	<p>(IO3.1)</p> <p>1. Shqipëria duhet te garantojë që të gjitha autoritetet licencuese të “Bizneseve dhe profesioneve të caktuara jo financiare” (DNFBP)²³ të jenë në gjendje të kontrollojnë lidhjet kriminale të licencave individuale të “Bizneseve dhe profesioneve të caktuara jo financiare” dhe personave që kontrollojnë apo administrojnë “Bizneset dhe profesionet e caktuara jo financiare” dhe të kenë burime të mjaftueshme dhe masa efektive në zbatim për të parandaluar depërtimin e elementeve kriminal në këto sektorë.²⁴</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Drejtësisë (MD) - Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA) - Banka e Shqipërisë (BSH) - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) - Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) - Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) 	<p>PRILL 2021</p>
--------------------	--	---	--------------------------

²³<http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/methodology/FATF%20Methodology%2022%20Feb%202013.pdf> DNFBP “Designated non-financial businesses and professions” (*mund të përshtatet ne shqip edhe si “Subjekte të sektorit jofinanciar dhe profesionet e lira”*) means:

- a) Casinos (References to Casinos throughout the FATF Standards include internet- and ship-based casinos)./ *Lojrat e fatit.*
- b) Real estate agents./ *Agjentët e pasurive të paluajtshme.*
- c) Dealers in precious metals./ *Tregtarët e metaleve të çmuara.*
- d) Dealers in precious stones./ *Tregëtarët e gurëve të çmuar.*
- e) Lawyers, notaries, other independent legal professionals and accountants – this refers to sole practitioners, partners or employed professionals within professional firms. It is not meant to refer to ‘internal’ professionals that are employees of other types of businesses, nor to professionals working for government agencies, who may already be subject to AML/CFT measures./ *Profesionet e lira si: Avokatët, Noterët, Ekspertët Kontabël*
- f) Trust and Company Service Providers refers to all persons or businesses that are not covered elsewhere under these Recommendations, and which as a business, provide any of the following services to third parties: / *Kompanitë e trustit*
 - acting as a formation agent of legal persons;
 - acting as (or arranging for another person to act as) a director or secretary of a company, a partner of a partnership, or a similar position in relation to other legal persons;
 - providing a registered office; business address or accommodation, correspondence or administrative address for a company, a partnership or any other legal person or arrangement;
 - acting as (or arranging for another person to act as) a trustee of an express trust or performing the equivalent function for another form of legal arrangement;
 - acting as (or arranging for another person to act as) a nominee shareholder for another person.

²⁴IO.3 “Albania should ensure that all DNFBP licensing authorities are able to check for criminal association of individual DNFBP licenses and persons controlling or managing DNFBPs and have sufficient resources and efficient measures in place to prevent criminal infiltration.”

	<p>(IO3.1.i.)</p> <p>Kjo përfshin në veçanti që:</p> <p>i. DHKA mund të përdorë si fakte gjatë procesit të licencimit, të dhëna që vërtetojnë gjendjen gjyqësore²⁵ të Avokatit lidhur me hetimin, ndjekjen penale apo procedimin penal në proces, nga prokuroria apo gjykata.²⁶</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i></p> <p>- Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA)</p>	<p>PRILL 2021</p>
	<p>(IO3.1.ii.)</p> <p>ii. BMP duhet të marrë masa për të parandaluar përfshirjen e personave me rekorde kriminale në kontrollin e deri 25% të votave (interesave) të firmave të auditimit dhe kontabilitetit të cilat mund të mbahen nga persona ose subjekte që nuk janë auditues të licencuar.²⁷</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i></p> <p>- Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP)</p>	<p>PRILL 2021</p>
	<p>(IO3.1.iii.)</p> <p>iii. të ekzistojnë kontrolle për të parandaluar që personat me precedentë penalë dhe bashkëpunëtorët e tyre të jenë përfituesit fundorë apo kontrolluesit e agjentëve të pasurive të paluajtshme²⁸.</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i> - Ministria e Drejtësisë (MD)</p> <p><i>Institucion Mbështetës:</i> - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)</p>	<p>PRILL 2021</p>

²⁵ Vërtetime që lëshohen nga prokuroria apo gjykata, që tregojnë gjendjen gjyqësore të Avokatit, për çështje që janë ende në proces shqyrtimi dhe nuk ka ende një vendim të formës së prerë.

²⁶ IO3.i. "This comprises in particular that: i) the NCA can use on-going criminal proceedings as evidence during the licensing process for lawyers."

²⁷ IO3. ii. "ii. the POB should take measures to prevent criminal infiltration within the 25% controlling interest in auditing and accounting firms which can be held by persons or entities who are not licensed auditors."

²⁸ IO3.1. iii. "iii. controls are in place to prevent criminals and their associates from beneficially owning or controlling real estate agents."

	<p>(IO3.2)</p> <p>2. Shqipëria duhet të sigurojë që BMP, MD dhe DHKA, kanë hartuar plane inspektimi për sektorët e tyre²⁹ bazuar në rreziqet e pastrimit të parave/financimit e terrorizmit (PP/FT) dhe se këto komponentë rrisht bazuar në PP/FT përfshihen në inspektimet e MD dhe DHKA.³⁰</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Drejtësisë (MD) - Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA) - Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) 	<p>SHTATOR 2020</p>
	<p>(IO.3.3)</p> <p>3. Shqipëria duhet të sigurojë që autoritetet kompetente në sektorin e “Bizneseve dhe Profesionet të caktuara jo-Financiare” (DNFBP) të mund të zbatojnë një sërë sanksione proporcionale dhe frenuese për shkeljet e pastrimit të parave dhe financimit e terrorizmit (PP/FT), duke përfshirë heqjen e çdo pengese të mundshme për heqjen e licencave.³¹</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Drejtësisë (MD) - Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA) - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) - Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) - Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) 	<p>PRILL 2021</p>

²⁹ që mbikëqyrin dhe licencojnë

³⁰ IO3.2 “2. Albania should ensure that the POB, MoJ, and NCA have developed inspection plans based on the AML/CFT risks of their sectors, and that risk based AML/CFT components are included in the inspections of the MoJ and NCA.”

³¹ IO3.3 “3. Albania should ensure that competent authorities in the DNFBP sector can apply a range of proportionate and dissuasive sanctions for AML/CFT breaches, including the removal of any possible obstacles to the revocation of licenses.”

IO.5	(IO.5.1) 1. Shqipëria duhet të krijojë një mekanizëm ligjor që siguron që të dhënat e regjistruara ³² në përputhje me detyrimet e transparencës ligjore të jenë të përditësuara dhe të verifikohen në mënyrën e duhur nga QKB dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. ³³	<i>Institucion kryesues:</i> - Ministria e Drejtësisë (MD) - Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	PRILL 2021
	(IO.5.2) 2. Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa shtesë për të siguruar që ekzistojnë mekanizma efektivë, për tu aksesuar në kohë nga autoritetet informacioni mbi pronarët përfitues të personave juridikë, duke aplikuar masa ndëshkuese ³⁴ në rast të mosrespektimit apo dhënies të informacionit të rremë ³⁵ , psh ndërtimi i plotë i Regjistrit të Pronareve Përfituese, i cili është në proces. ³⁶	<i>Institucion kryesues:</i> - Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) <i>Institucion Mbështetës:</i> - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)	QERSHOR 2021

³² Të dhënat që rregjistrohen nga QKB për subjektet tregëtare dhe subjektet e tjera, si dhe të dhënat që rregjistrohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për subjektet OJF/ Organizata Jo-Fitimprurëse.

³³IO.5.1 “1. Albania should establish a legal mechanism that ensures that the data which is filed according to the legal transparency obligations is up-to-date and appropriately verified by the NBC and DCoT.”

³⁴ masa administrative (gjoba)

³⁵ Informacionin e pa vërtetë

³⁶ IO.5.2 “2. Albania should take additional steps to ensure that there are effective mechanisms for timely access by authorities to information on beneficial owners of legal persons, with appropriate penalties for non-compliance and the provision of false information, for example by establishing the Beneficial Ownership register, which is underway.”

	<p>(IO.5.3)</p> <p>3. Shqipëria duhet të sigurojë një kornizë të përshtatshme ligjore për shkeljet e detyrimeve të regjistrimit për personat juridikë dhe Organizatat Jo-fitimprurëse dhe të zbatojë sanksione më proporcionale dhe frenuese duke marrë parasysh barazinë e fuqisë blerëse (nivelel ekonomik)³⁷.</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Drejtësisë (MD) - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) <p><i>Institucion Mbështetës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë 	<p>PRILL 2021</p>
--	---	--	--------------------------

³⁷ IO.5.3 “3. Albania should ensure an adequate legal framework for violations of the registering obligations for LEs and NPOs and implement more proportionate and dissuasive sanctions which take account of purchasing power parity.”

IO.7	(IO.7.1)	<p>1. Shqipëria duhet të krijojë një sistem statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave (PP) për të siguruar një bazë të besueshme për reforma të mëtejshme për të rritur numrin e procedimeve penale dhe dënimeve për “pastrimin e parave”. Sistemi, në përgjithësi, duhet të japë mundësinë për të bërë krahasim të veprimeve të ndërmarra nga institucionet ligj-zbatuese hetimore, prokurorisë, vendimeve të gjykatave, përfshirë këtu edhe dënimet e dhëna, për sa të jetë e mundur ky sistem të tregojë edhe llojin dhe përdorimin e informacionit iniciues të çështjeve/ indicjen (p.sh. Raporte të Transaksioneve të Dyshimta (RAD), informacione të marra nga publiku, raporte të kontrollit doganor) në punën e institucioneve ligj zbatuese / gjyqësorit.³⁸</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Prokuroria e Përgjithshme (PP) - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) <p><i>Institucion Mbështetës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Prokuroria e Posaçme (SPAK) - Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) 	PRILL 2021
	(IO.7.2)	<p>2. Shqipëria duhet të demonstrojë që ndjek më shumë procedime penale për veprat penale të pastrimit të parave, me fokus të veçantë vepra penale të kryera jashtë juridiksionit të Republikës</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Prokuroria e Përgjithshme (PP) - Prokuroria e Posaçme (SPAK) 	QERSHOR 2021

³⁸ IO.7.1 “1. Albania should establish a system of statistical monitoring of ML cases to provide a reliable basis for further reforms to increase the number of ML indictments and ML convictions. The system should generally allow for a comparison of LEA investigations, prosecutions, court decisions and the sanctions imposed and, to the extent possible, give an indication of the use of initial information (e.g. STRs, information from the public, customs control reports) in the work of the LEAs/judiciary.”

	së Shqipërisë, duke përfshirë mbështetjen në prova (prova rrethanore). ³⁹		
IO.8	(IO.8) Shqipëria duhet të rrisë fokusin dhe përpjekjet e institucioneve ligj zbatuese dhe institucionit të Prokurorisë në zbatimin e gamës së plotë të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, veçanërisht duke u përqendruar në palët e treta të përfshirë në pastrimin e parave (PP), nga profesionet e lira dhe nga vetë subjektet raportuese (gatekeeper), si dhe për asetet që përfaqësojnë të ardhura indirekte dhe vlerë ekuivalente. ⁴⁰	<i>Institucion kryesues:</i> - Prokuroria e Përgjithshme (PP) - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) - Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara	DHJETOR 2020

³⁹ IO.7.2 “2. Albania should demonstrate that it pursues more indictments of ML offences, with a particular focus on cases with a foreign predicate offence, including placing reliance on circumstantial evidence.”

⁴⁰ IO.8 “Albania should enhance the focus and efforts of the LEA and prosecutorial authorities on the application of the full range of seizure and confiscation measures, particularly by targeting 3rd party ML by professionals and gatekeepers, as well as assets that represent indirect proceeds and equivalent value.”

IO.10	(IO.10.1) 1. Shqipëria duhet të rrisë ndjeshëm angazhimin me “Institucionet financiare” (FI) dhe me “Bizneset dhe Profesionet e caktuara jo-financiare” (DNFBPs) (veçanërisht me ato subjekte që Shqipëria ka identifikuar të ketë njohuri të pamjaftueshme dhe / ose përmbushjes të “Sanksioneve financiare të specifike”/ TFS) ⁴¹ duke realizuar një komunikim dinamik, të rregullt (në plotësim të detyrimit për njoftimin e udhëzimeve të përditësuara mbi “Listën e personave të shpallur”). ⁴²	<i>Institucion kryesues:</i> Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP) <i>Institucione Mbështetëse:</i> - Ministria e Drejtësisë (MD) - Dhoma Kombëtare e Avokatëve (DHKA) - Banka e Shqipërisë (BSH) - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) - Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) - Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)	SHTATOR 2020
	2. Shqipëria duhet të sigurojë që procedurat përkatëse të inspektimit nga subjektet mbikëqyrësve (përfshirë, potencialisht, përmes rishikimit) dhe inspektimet aktuale të kryera për vlerësimin e pajtueshmërisë të “Sanksioneve financiare specifike” (TFS) për “personat e shpallur” janë dukshëm të mjaftueshme për të	<i>Institucion kryesues:</i> Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP) <i>Institucione Mbështetëse:</i> - Ministria e Drejtësisë (MD) - Dhoma Kombëtare e Avokatëve (DHKA) - Banka e Shqipërisë (BSH)	SHKURT 2021

⁴¹ Sanksionet financiare specifike që lidhen me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit/ TFS “Targeted financial sanctions” “The term targeted financial sanctions means both asset freezing and prohibitions to prevent funds or other assets from being made available, directly or indirectly, for the benefit of designated persons and entities.” <http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/methodology/FATF%20Methodology%2022%20Feb%202013.pdf>

⁴² IO.10.1 “1. Albania should significantly enhance engagement with FIs and DNFBPs (especially those that Albania has identified to have insufficient understanding of and/or compliance with TFS obligations) by conducting proactive, regular outreach (additional to dissemination of updated guidance)”.

	<p>identifikuar dhe korrigjuar mangësitë në pajtueshmërinë e vendosjes të “sanksioneve financiare specifike për personat e shpallur” (TFS) midis institucioneve financiare (FI)-ve dhe "Bizneseve dhe Profesioneve të caktuara jo-Financiare" (DNFBPs).⁴³</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) - Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) - Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) 	
--	--	---	--

⁴³ IO.10.2 “2.Albania should ensure that relevant supervisor’ inspection procedures (including, potentially, through revision) and actual, conducted inspections for assessing TFS compliance are demonstrably sufficient to identify and rectify deficiencies in TFS compliance among FIs and DNFBPs.”

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Përkthim “Jo - zyrtar” i DPPPP

ANEKS. 2

PLANI I VEPRIMIT TË ICRG/ FATF⁴⁴*(me nën - hapa)*

Institucioni Përgjegjës: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

Rezultati imediat (Immediate Outcome) IO	PIKA E VEPRIMIT / NËN- HAPI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS/	AFATI
IO.1	(IO1.1) 1. Shqipëria duhet të kryejë analiza të mëtijshme për sektorë specifikë dhe produkte specifike që paraqesin rrezik dhe ekspozim lidhur me “pastrimin e parave” ⁴⁵ , me fokus të veçantë në sektorin e pasurive të paluajtshme, agjentët e pasurive të paluajtshme, avokatët, ekspertët kontabël dhe shpërdorimin me forma të ndryshme të veprimtarisë të personave juridikë. ⁴⁶	<i>Institucion kryesues:</i> Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të parave (DPPPP) <i>Institucione Mbështetëse:</i> - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)	SHKURT 2021 Afati fundor ⁴⁷ : KORRIK 2020

⁴⁴Plan veprimi i ICRG (International Cooperation Review Group) / Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, pjesë e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (Financial Action Task Force / FATF)

⁴⁵ Money laundering (ML)/ pastim parash (PP)

⁴⁶IO.1. “Albania should conduct further analysis in relation to the sector-specific and product-specific ML threats and vulnerabilities, with particular emphasis on immovable property, real estate agents, lawyers, accountants and the misuse of different types of legal persons.”

⁴⁷“Afat fundor” nën kupton afatin e vendosur nga ICRG/ FATF. Pika e veprimit/ nën hapi duhet të jenë domosdoshmërisht të përmbushur Brenda afatit të përcaktuar fundor.

	<p>(i) AMF duhet të hartojë një plan të hollësishëm lidhur me nevojat për trajnim me fokus të veçantë për pasqyrimin e rekomandimeve dhe detyrave të ICRG/ FATF dhe Moneyval/ rreziqet nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.</p> <p>(ii) AMF në bashkëpunim me DPPPP të organizojë trajnimet në lidhje me rritjen e vigjilencës së duhur/ pastrimin e parave/ financimin e terrorizmit dhe rekomandimet e FATF.</p>	<p>- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)</p>	<p>Afati (i) Maj 2020</p> <p>Afati (ii) Korrik-Shtator 2020</p>
	<p>2. Shqipëria duhet të sigurojë që procedurat përkatëse të inspektimit nga subjektet mbikëqyrësve (përfshirë, potencialisht, përmes rishikimit) dhe inspektimet aktuale të kryera për vlerësimin e pajtueshmërisë të “Sanksioneve financiare specifike” (TFS) për “personat e shpallur” janë dukshëm të mjaftueshme për të identifikuar dhe korigjuar mangësitë në pajtueshmërinë e vendosjes të “sanksioneve financiare specifike për personat e shpallur” (TFS) midis institucioneve financiare (FI)-ve dhe "Bizneseve dhe Profesioneve të caktuara jo-Financiare" (DNFBPs).⁵¹</p> <p>(i) AMF duhet të hartojë plane inspektimi bazuar në TFS.</p>	<p><i>Institucion kryesues:</i> Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP)</p> <p><i>Institucione Mbështetëse:</i></p> <p>- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)</p> <p><i>Institucion kryesues (i, ii):</i></p> <p>- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)</p>	<p>SHKURT 2021</p> <p>Afati (i) Maj 2020</p>

⁵¹ IO.10.2 “2.Albania should ensure that relevant supervisor’ inspection procedures (including, potentially, through revision) and actual, conducted inspections for assessing TFS compliance are demonstrably sufficient to identify and rectify deficiencies in TFS compliance among FIs and DNFBPs.”

	(ii) AMF duhet të realizojë inspektime bazuar në TFS.		Afati (i) Maj 2020– Shkurt 2021
--	---	--	--

